



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

NDËRMARRJET SOCIALE

UDHËZUES

THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM DHE MARRJEN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE SOCIALE

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kjo është thirrja e parë për aplikim, për marrjen e statusit dhe regjistrimin, në kuadër të ngritjes së ndërmarrjeve të para sociale, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo iniciativë shërben për të mbështetur organizatat jofitimprurëse që synojnë ofrimin e shërbimeve dhe duhet të kontribuojë në hapjen e vendeve të reja të punës, duke punësuar persona nga lista e grupeve të pafavorizuara, tashmë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Qëllimi dhe fushëveprimi i Thirrjes për Aplikime

Regjistrimi dhe përfitimi i statusit të Ndërmarrjeve Sociale

Ngritje e Ndërmarrjeve Sociale për:

- Mundësi punësimi për personat, të cilëve moshë, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon të jenë aktivë në tregun e punës
- Punësim të individit për burime të mjaftueshme jetese në përputhje me dinjitetin njerëzor.
- Integrim ekonomik e social të grupeve në nevojë, duke nxitur përgjegjshmërinë, solidaritetin dhe kohezionin shoqëror në komunitet.
- Ofrim të larmishëm të mallrave dhe shërbimeve me cilësi të mirë, mundësi për individët me nevoja të veçanta duke synuar barazi gjinore.

Kush mund të aplikojë

Vetëm organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të aplikojnë për të marrë statusin “ndërmarrje sociale”, që duhet të plotësojnë një minimum kriteresh ekonomike dhe sociale të përcaktuara nga ligji, Nr. 65/20 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të përfituar dhe mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale;

Kritere ekonomike:

1. Ndërmarrja sociale duhet të ushtrojë në mënyrë të vazhdueshme një veprimtari në fushën e prodhimit të mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve.
2. Të paktën, 20 për qind e të ardhurave, pas vitit të dytë të aktivitetit dhe, të paktën, 30 për qind e të ardhurave, pas vitit të tretë e në vijim të aktivitetit, duhet të realizohen nga veprimtaritë e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Në veprimtarinë e saj ndërmarrja sociale, përveç kontributit të vullnetarëve, duhet të përfshijë domosdoshmërisht, të paktën, 3 punonjës me pagesë.
4. Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria ekonomike e ndërmarrjeve sociale i shërbejnë zgjerimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së tyre.

Kritere sociale:

1. Ndërmarrja sociale synon nxitjen e objektivave sociale në një fushë veprimtarie të mirëpërcaktuar.
2. Të paktën, 30 për qind e punonjësve të punësuar në ndërmarrjen sociale duhet t'i përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga programi i Mbrojtjes Sociale nga pikëpamja sociale dhe ekonomike.

Procedurat e aplikimit për marrjen e statusit të Ndërmarrjes Sociale

Sipas Udhëzimit Nr. 607, datë 01.08.2018 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, procedura e marrjes së statusit iniciohet nga vetë organizata jofitimprurëse me anë të një kërkesë drejtuar Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

2.1. Kërkesa paraqitet në MSHMS-së nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar prej tij sipas formatit të aplikimit të miratuar nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve. Propozimet duhet të dorëzohen duke përdorur Formularin e Aplikimit (Shtojca A).

2.2 Kërkesa duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajë edhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së organizatës dhe parashtrim të arsyeve se si organizata përmbush kriteret ekonomike dhe sociale të parashikuara në ligj për ndërmarrjet sociale.

2.3 Kur një ndërmarrje sociale ushtron veprimtari për të cilat nevojitet licencë, pajisja me licencë, sipas përcaktimeve ligjore që rregullojnë licencimin, duhet të sigurohet përpara aplikimit për marrjen e statusit.

2.4 Krahas kërkesës për marrjen e statusit, subjektet e interesuara duhet të paraqesin:

- a) Një vërtetim të lëshuar, jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit, nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- b) Një kopje të statutit dhe aktit të themelimit;

- c) Një vendim të organit më të lartë vendimmarrës të organizatës jofitimprurëse ku të shprehet qëllimi i organizatës për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale;
- ç) Dokumente të tjera që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve ekonomike e sociale;
- d) Kopje të licensës, nëse do të jetë rasti;
- dh) Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti.

2.5 Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose kur vlerësohet e arsyeshme, strukturat përkatëse mund të kërkojnë dokumentacion shtesë përveç atij të paraqitur nga kërkuesi.

2.6 Nëse vlerësohet e nevojshme, gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesës, strukturat përkatëse pranë MSHMS mund të kryejnë vizitë vlerësuese në mjediset ku ushtron veprimtarinë organizata.

2.7 Në çdo rast kërkuetit njoftohen për vendimin e njohjes apo refuzimit të statusit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.

2.8 Në rast të përmbushjes së kriterëve ligjore, njohja e statusit bëhet me Urdhër të ministrit.

2.9 Në rast të refuzimit të statusit, njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyet e refuzimit.

2.10 Në rast të njohjes së statusit, organizata jofitimprurëse detyrohet të përdorë emërtimin “Ndërmarrje Sociale” përkrah emrit të organizatës, dhe regjistrohen si të tilla në regjistrin e mbajtur nga MSHMS.

2.11 Regjistrimi fillestar në regjistër bëhet nga MSHMS pa kërkesë apo njoftim nga subjekti që merr statusin e ndërmarrjes sociale, ndërsa çdo ndryshim në të dhënat e regjistrimit duhet të njoftohet me shkrim nga subjektet, brenda 10 ditëve kalendarike, në MSHMS, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë.

Si dhe ku të dërgoni aplikimet për regjistrimin dhe marrjen e statusit të Ndërmarrjeve Sociale

Aplikimi duhet të dorëzohet në dy kopje. Aplikimi duhet të sigurohet gjithashtu në format elektronik (CD-ROM ose disk USB). Formatit elektronik duhet të përmbajë të njëjtin propozim si versioni i letrës bashkëngjitur.

Propozimet e plota duhet të pranohen në një zarf të mbyllur me anë të postës së regjistruar, pranë ministrisë në adresën e mëposhtme:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga Kavajës, nr.1001, Tiranë

Me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.326, datë 12.04.2019 është ngritur Komisioni Vlerësues i aplikimeve të subjekteve, për të përfituar statusin ndërmarrjeve sociale, i cili asistohet nga Sekretariati Teknik, që ka këto detyra:

1 Sekretariati i Komisionit të Vlerësimit asiston të interesuarin në plotësimin e formularit të aplikimit, si dhe verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar. Sqarime do të kërkojnë vetëm nga sekretariati teknik i MSHMS në emër të Grupit të Punës kur informacioni i dhënë është i paqartë.

2 Dokumentet paraqiten në origjinal, një kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin ose një kopje të panjësuar me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit.

3 Kur kërkesa paraqitet nga personi i autorizuar, sipas pikës 1 të këtij neni, bashkë me dokumentet paraqitet edhe dokumenti që vërteton faktin e të qenit i autorizuar.

4 Sekretariati i Komisionit lëshon një konfirmim, me shkrim, për çdo kërkesë. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar nga Komisioni dhe duhet të tregojë llojin e kërkesës, datën dhe listën e dokumenteve të dorëzuara.

5 Aplikimi do të pajiset me një numër rendor dhe do të regjistrohet në protokollin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

6 Sekretariati i Komisionit është i detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

7 Aplikimi do të pajiset me një numër aplikimi dhe do të regjistrohet në Regjistrin e Ndërmarrjeve Sociale.

8 Sekretariati i Komisionit duhet të sigurohet të plotësojë saktësisht dosjen përpara mbledhjes së Komisionit.

Procedura Administrative. Vlerësimi dhe marrja e vendimit

1 Vlerësimi dhe përzgjedhja e propozimeve do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me Urdhër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Të gjithë anëtarëve të Grupit të Punës vlerësues, u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë të paanshmërisë dhe të angazhohen për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave dhe rezultateve, gjatë dhe pas procesit të vlerësimit, si dhe për çdo konflikt interesi me aplikantin.

2 Komisioni i Vlerësimit do të marrë në dorëzim dhe do të analizojë aplikimin, për t'u siguruar në lidhje me plotësimin siç duhet të aplikimit, si dhe me pranueshmërinë e aplikimit.

3 Vendimi për miratimin ose refuzimin e një aplikimi bazohet vetëm mbi dokumentet e paraqitura.

4 Komisioni gjatë shqyrtimit të çdo aplikimi merr në konsideratë kriteret e përcaktuara në ligj, të përmendura në pikën 1 të këtij Udhëzimi.

5 Rezultatet e të gjitha kërkesave të dorëzuara që do të vlerësohen nga Grupi i punës, për funksionimin e Ndërmarrjeve Sociale dhe të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të realizohen sipas hapave në vijim:

Hapi 1: Verifikimi Administrativ

Gjatë kryerjes së verifikimit administrativ do të vlerësohen si më poshtë:

☞ Dokumentacioni dhe / ose informacioni i munguar ose i pasaktë. Nëse mungon ndonjë prej dokumenteve (duke përfshirë anekset) ose informacioneve të kërkuara, propozimi refuzohet.

Hapi 2: Marrja e vendimit dhe njoftimi i aplikuesit

Pas mbledhjes së Komisionit, bëhet njoftim i aplikuesit nga Sekretariati Teknik duke iu referuar në mënyrë specifike Aplikimit, në një afat prej 2 ditësh pune, se:

- i. Aplikimi për marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve sociale është refuzuar nga komisioni i vlerësimit të aplikimeve duke listuar dhe arsyet e refuzimit.
- ii. Aplikimi është miratuar nga komisioni i vlerësimit të aplikimeve.

Njoftimi bëhet me postë zyrtare sipas formatit të miratuar nga kryetari i komisionit.

Afate të rëndësishme

☞ Data e fillimit të thirrjes: 6 Maj 2019

☞ Afati i fundit për marrjen e sqarimeve: Jo më vonë se 10 ditë nga dita e aplikimit

☞ Afati i fundit për shqyrtimin e aplikimeve për marrjen e Statusit të Ndërmarrjeve Sociale : Jo më vonë se 30 ditë nga dita e aplikimit.

Informacione të mëtejshme

Pyetjet mund të dërgohen vetëm me e-mail në këtë adresë sekretariatiteknikNS@shendetesia.gov.al; duke treguar qartë referencën e thirrjes për aplikime. Përgjigjet do t'u jepen pyetjeve të parashtruara jo më vonë se 10 ditë nga dita afatit e pranimi të aplikimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Shtojca A

Formulari i Aplikimit

1. Të dhëna të Ndërmarrjes Sociale:

Emri i Ndërmarrjes Sociale		
Përfaqësuesi/personi i autorizuar për të bërë aplikimin		
Adresa Rruga Qyteti		
Tel		
Fax		
E-mail		
Ëëbsite:		
Viti i krijimit		
Statusi Ligjor		
Përqindja e pronësisë së huaj		
Kualifikimi si NS	Numri i stafit	Xhiro vjetore (Lek)
Mikro	<input type="checkbox"/> < 10	<input type="checkbox"/> < 10 milion
E vogël	<input type="checkbox"/> < 50	<input type="checkbox"/> < 50 milion
Produktet /shërbimet kryesore		

